



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit në lidhje me pretendimin për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, deklaratat përmbyllëse janë caktuar të mbahen më 10, 11 dhe 14 shtator 2026 dhe seancat do të fillojnë në orën 9:30 paradite, në të tri ditët.

Më 20 gusht, Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes miratoi kërkesat e Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit për pjesëmarrje në deklaratat përmbyllëse përmes videolidhjes.

Gjatë deklaratave përmbyllëse, palët paraqitin përmbledhtazi argumentet e tyre dhe mund t' referohen provave të pranura dhe mbështetshmërisë në to, besueshmërisë së dëshmitarëve, dokumentacionit të procesit gjyqësor dhe kornizës ligjore përkatëse. Sipas Rregullores, Prokurorja e Specializuar fillon e para me deklaratën përmbyllëse e më pas vijojnë ekipet e Mbrojtjes. Pas kësaj palët kanë të drejtë t'i përgjigjen njëra-tjetrës dhe akuzuarit kanë të drejtë të flasin të fundit. Pas deklaratave përmbyllëse, Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes mbyll çështjen gjyqësore.

Deklaratat përmbyllëse do të jenë publike dhe mund të përcillen në shqipe, anglishte ose serbishte përmes faqes transmetuese të DHSK-së në internet me një vonesë 45-minutëshe, ose nga galeria për publikun në gjykatë.

Mesazhe elektronike konfirmuese u janë dërguar të gjithë personave që janë regjistruar paraprakisht për të qenë të pranishëm në deklaratat përmbyllëse. Kushdo që ka marrë konfirmim, është i lutur të sjellë më vete një dokument identifikimi të vlefshëm dhe gjithashtu gazetarët duhet të paraqesin kartelën e shtypit të hyrja.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, shqiptimi i Aktgjykimit është caktuar të mbahet më 16 shtator 2026, e fillon në orën 10:00 paradite.

Ka përfunduar procesi i dërgimit të mesazheve elektronike të gjithë personave që paraqitën kërkesë për prani fizike gjatë seancës në Dhomat e Specializuara.

Krahas galerisë për publikun ku numri i ulëseve është i kufizuar, DHSK-së do të mundësojë për mediat sallën e konferencave të shtypit dhe qendrën për median. Salla për konferencat e shtypit do të përdoret posaçërisht që gazetarët të mund të përcjellin seancën nga ekranet me një vonesë 10-minutëshe. Në qendrën për median, e cila shërben si vend për të punuar për median, gazetarët mund të incizojnë transmetimin me vonesë të seancës dhe të përgatisin artikujt e tyre.

Kërkojmë mirëkuptimin e personave që nuk mund të jenë të pranishëm atë ditë në ndërtesë, pasi interesi për të përcjellë këtë seancë ka qenë jashtëzakonisht i madh, numri i ulëseve ishte i kufizuar dhe ishte e





domosdoshme t'u jepej përparësi familjarëve të ngushtë. Seanca do të transmetohet përmes faqes transmetuese në internet, ku mund të shihet ngado në botë, në shqipe, anglishte ose serbishte me një vonesë të shkurtër prej 10 minutash.

